VENDIM
Nr.81, datë 17.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.4, DATË 16.9.2009 "PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE, BYROSË DHE PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 55 pika 1 dhe nenit 8 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë "Lëvizja Socialiste për Integrim",

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin nr.4, datë 16.9.2009 "Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve, byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit", të ndryshuar, në pikën II bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Vangjel Tavo zgjidhet Zëvendëskryetar i Kuvendit në vend të deputetit Nasip Naço.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)